

V E N D I M
Nr.253, datë 22.5.1995

PËR NDRYSHIMIN E PAGËS MESATARE PËR EFEKT KONTROLLI

Me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.345, datë 10.8.1992 "Për shpërblimin e punës së punonjësve", të bëhen këto ndryshime:

- 1) Në pikën 2, paga minimale mujore për punonjësit bëhet 3300 lekë.
 - 2) Në pikën 3, paga mesatare për efekt kontrolli sipas ministrive për vitin 1995 është sipas listës që i bashkëngjitet këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 1995.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

PAGA MESATARE PËR EFEKT KONTROLLI
SIPAS MINISTRIVE PËR VITIN 1995

Nr.MinistritëPaga mesatare

1.Ministria e Burimeve Minerare dhe energjetike.	4860
2.Ministria e Ndërtimit dhe Turizmit	4100
3.Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë	4090
4. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit	4550
5.Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	3770
6.Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit	4030
7.Ministria e Brendshme	3910
8.Ministria e Arsimit	3760
9.Ministria e Mbrojtjes	4060
10.Drejtoria e Informatikës Ekonomike	3860
11.Drejtoria e Shërbimit Qeveritar	5060
12.Banka e Shqipërisë	5190
13.Banka Kombëtare Tregtare	4250
14.Banka e Kursimeve	4250
15.Banka Bujqësore dhe e Zhvillimit	4050
16.Instituti i Sigurimeve (INSIG)	5190
17.Ministria e Punës së Jashtme	4310
18.Agjencia e Ristrukturimit të Ndërmarrjeve	4710
19.Ministria e Financave (shtypshkronja e letrave me vlerë)	4230